



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT

OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPAL GJILAN / GILAN BELEDIYESI



KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

KUVENDI KOMUNAL- GJILAN, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një rën anë;
dhe

Grup i Operatorëve Ekonomik A.R.F. SH.P.K. & N.T.P. Office - Printy, nga **Prishtina** (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizim me:

Furnizim me material botues për të gjitha njësit kërkuese në Komunën e Gjiçanit

me numër identifikues: 651-18-7755-1-1-1

me numër të brendshëm të prokurimit: GL 651 18 068 111

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë furnizimi nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

Furnizim me material botues për të gjitha njësit kërkuese në Komunën e Gjiçanit – sipas përshkrimit në ankesin 1 Specifikat teknike të detyrueshme

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indicative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë mallëra; të përmendura në 1.1.

1.5 Kontrata hynë në fuqi me **datën e nënshkrimit nga të dy palët** dhe përfundon në një afat prej **36 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës**.

Neni 2

Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë **jo më von se 3 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **Kuvendi Komunal në Gjiçan**.

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

¹ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara – Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet njësi të furnizimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Furnizuesi Vlera totale indikative e kontratës është : **49.888,00 Euro**. Devijimi i lejuar nga vlera totale indikative nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus 30%.

Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim:

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve); **23.01.2019**

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në

komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	U.D Izet Kurteshi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	25.03.2019
Vula:	

Për Furnizuesin

Emri:	Avdi Koca
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	25.03.2019
Vula:	

PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	8.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është jo më pak se 4,988.80 € me afat vlefshëmëri prej jo më pak se 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët.
Sigurimi	9.1	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Cilësia e furnizimeve	16.2	<i>N/A</i>
Inspektimi dhe testimi	17.2	Inspektimi dhe testimi do të kryhen me rastin e dorëzimit dhe në përputhje me Nenin 19 të Kushteve të Përgjithshme në adresat e specifikuar në Nenin 2.2 të Kontratës.
Dorëzimi	19.3	Furnizuesi do të bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranimin në destinacion. Furnizimet duhet të paktohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre. Dërgesa: Dërgesat do të bëhet brenda jo më larg se 3 ditë pas marrjes së "urdhër blerjes" nga ana e Furnizuesit. Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).
Obligimet e garancionit	22.1	<i>Sipas KPK</i>
Shërbimet pas shitjes	23.1	<i>N/A</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - Divizioni i rregullave
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike. ose

	<p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	---